
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 21.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

ME OBJEKT: Ngritja e Qendres me Sistemet Multiaplikative të Identifikimit Biometrik te personit (amais) Qendres se Funizimit Materialo-Teknik-Mullet- Kontratë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Pajisje elektronike-31710000-6

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **me fond limit** 223,600,000 (dyqind e njezetë e tre milion e gjashtëqind mijë) Lekë **pa TVSH** ose 2,387,103.66 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tre pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar për procedurën e prokurimit “**Ngritja e Qendres me Sistemet Multiaplikative të Identifikimit Biometrik te Personit (amais) Qendres se Funizimit Materialo-Teknik-Mullet- Kontratë** ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë autoritetit kontraktor përfitues për **Qendres se Funizimit Materialo-Teknik-Mullet- Kontratë** janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *“3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

Në rastin konkret Njësisa e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për

njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë autorizim me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë për cilësinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatorin ekonomik ofertues. Autoriteti kontraktor ka nevojë të sigurohet që produktet që po ofrohen janë të besueshme dhe të cilësisë së kërkuar. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, siguron që çdo produkt të mund të verifikohet dhe të ketë një burim të njohur dhe të verifikuar. Përsa i përket lidhjes midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit, kjo kërkesë është e rëndësishme për të vërtetuar që distributori është i autorizuar dhe se ka një marrëdhënie të ligjshme me prodhuesin. Kjo ndihmon në shmangien e mundësisë së përdorimit të produkteve të falsifikuara ose të paautorizuara.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/skeda teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikullin e ofruar, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike.

Argumentimi: Publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknik të kërkuar në DST me qëllim që komisioni të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë** se afati garancisë së mallrave objekt prokurimi do të jetë të paktën 1 (një) vit nga dorëzimi i mallit pranë autoritetit kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kërkesa për deklarimin e një garancie minimale prej 1 (një) viti është vendosur për të garantuar funksionimin normal të mallrave pas dorëzimit dhe për të siguruar zëvendësimin ose riparimin e tyre në rast defektesh të prodhimit gjatë periudhës së garancisë. Afati i garancisë është proporcional me natyrën e mallrave objekt prokurimi dhe garanton mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor.

5. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent.
- ISO/IEC 27001:2023 /“Menaxhimi i sigurisë së informacionit” (e vlefshme) ose ekuivalent.

Argumentimi:Kërkesa për paraqitjen e certifikatave **ISO 9001:2015** dhe **ISO/IEC 27001:2022**, ose ekuivalente, është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik disponon sisteme të standardizuara dhe të certifikuara për menaxhimin e cilësisë dhe të sigurisë së informacionit, të cilat janë të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

Certifikata **ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë** dëshmon se operatori ekonomik zbaton procese të strukturuar për planifikimin, organizimin, kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së tij. Ky standard siguron që produktet dhe shërbimet të ofrohen në mënyrë të qëndrueshme, në përputhje me kërkesat kontraktuale dhe ligjore, duke minimizuar rrezikun e gabimeve dhe duke garantuar një nivel të lartë të cilësisë gjatë zbatimit të kontratës.

Ndërkohë, certifikata **ISO/IEC 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit** garanton se operatori ekonomik ka vendosur politika, procedura dhe kontrolle efektive për mbrojtjen

e informacionit, duke siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e tij. Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme në kontratat ku operatori do të administrojë, përpunojë ose ketë akses në të dhëna, sisteme informatike ose informacione me karakter institucional, pasi redukton rrezikun e incidenteve të sigurisë dhe siguron përputhshmërinë me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Pranimi i certifikatave **ose ekuivalente** respekton parimin e mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, duke u mundësuar operatorëve ekonomikë të provojnë përmbushjen e të njëjtit nivel standardesh edhe nëpërmjet certifikimeve të tjera të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Për rrjedhojë, kërkesa për këto certifikata është objektive, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi synon të sigurojë që kontrata të realizohet nga operatorë ekonomikë që disponojnë kapacitetet organizative dhe teknike të nevojshme për të garantuar cilësi të lartë të shërbimit dhe një nivel të përshtatshëm të sigurisë së informacionit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj.

6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të pakten 10 (dhjetë) punonjës për muajin e fundit nga data e publikimit të njoftimit të shkurtuar të kontratës. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqese vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e mësipërme shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formularit E/Sig-25 si dhe të vetedeklarojë në Shtojcën 9 ku të përfshihen:

Të paktën 3 (tre) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion.

Për punonjësit e diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion duhet të paraqitet:

- Diplomë Universitare Bachelor ose Mastër.
- Kontratë pune të vlefshme;
- Listëpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e publikimit të njoftimit të shkurtuar të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjësit e certifikuar si mëposhtë:

- 2 (dy) punonjës të kualifikuar, të certifikuar/autorizuar nga prodhuesi, distributori ose ekuivalent.
- 1 (një) punonjës të kualifikuar me certifikatë **CCNA ose ekuivalente**.
- 1 (një) punonjës të kualifikuar dhe të certifikuar për sigurinë në sistemet informatike, i pajisur me **certifikatë CompTIA Security+ ose certifikim ekuivalent**

Për punonjësit e certifikuar

- Kontratë pune të vlefshme.

- Certifikimet përkatëse.
- Listpagesat e shoqërise minimumi muajin e fundit të deklaruar nga publikimi i njoftimit të shkurtuar i kontratës.

Shenim: Kriteri i përcaktuar në pikën 6 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Sqarim: Një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar më sipër.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e tij të paktën 10 (dhjetë) punonjës, si dhe specialistët e diplomuar dhe të certifikuar sipas kërkesave të mësipërme, është vendosur për të garantuar se ofertuesi disponon kapacitetin e nevojshëm njerëzor dhe profesional për realizimin me sukses të kontratës. Natyra e objektit të prokurimit kërkon personel të kualifikuar në fushën e teknologjisë së informacionit, elektronikës, telekomunikacionit dhe sigurisë informatike, të aftë për instalimin, konfigurimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike të pajisjeve dhe sistemeve që janë objekt i kontratës.

Kërkesa për të paktën 3 (tre) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Mekatronikë ose Telekomunikacion siguron që operatori ekonomik të ketë burimet profesionale të nevojshme për realizimin e shërbimeve dhe punimeve sipas specifikimeve teknike.

Gjithashtu, kërkesa për personel të certifikuar nga prodhuesi/distributori ose ekuivalent, si dhe për specialistë të pajisur me certifikata CCNA (ose ekuivalente) dhe CompTIA Security+ (ose ekuivalente), është në përputhje me natyrën e kontratës dhe garanton që stafi zotëron njohuritë dhe kompetencat praktike për administrimin e rrjeteve, konfigurimin e pajisjeve dhe zbatimin e praktikave të sigurisë kibernetike.

Këto kërkesa janë vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar pasi lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me përmasat, kompleksitetin dhe rëndësinë e saj. Kërkesat synojnë të garantojnë që operatori ekonomik fitues të ketë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin cilësor dhe brenda afatëve të kontratës.

Prania e punonjësve të kualifikuar garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për:

- instalimin korrekt të pajisjeve sipas specifikimeve teknike të prodhuesit;
- konfigurimin dhe integrimin e tyre në infrastrukturën ekzistuese;
- kryerjen e testeve funksionale dhe verifikimin e performancës së sistemeve;
- diagnostikimin dhe zgjidhjen e problematikave teknike që mund të shfaqen gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës, diplomës universitare dhe listpagesës së muajit të fundit ka si qëllim verifikimin e disponueshmërisë reale të stafit të deklaruar, kualifikimit profesional të tij dhe marrëdhënies së rregullt të punës me operatorin ekonomik. Këto dokumente shërbejnë si prova objektive për të vërtetuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Ky kriter është në përpjesëtim me objektin dhe vlerën e kontratës, nuk krijon kufizime të panevojshme për konkurrencën dhe është vendosur në përputhje me parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe garantimit të ekzekutimit cilësor të kontratës.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit e mallit objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Qendra e Funizimit Materialo-Tekniko Mullet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Grupi i punës i ngritur pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit**, ka hartuar specifikimet teknike për secilën pajisje si më poshtë vijon:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, janë hartuar nga ana e njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Kriteri për disponimin e personelit është hartuar nga specialistët e fushës (inxhinierët), në përputhje me specifikimet teknike. Përcaktimi i numrit të punonjësve, profileve profesionale dhe certifikimeve nuk është bërë në mënyrë formale, por mbi bazën e kompleksitetit teknik të objektit të prokurimit, proceseve që do të realizohen gjatë ekzekutimit të kontratës, standardeve teknike të kërkuara nga prodhuesit dhe nevojës për të garantuar vazhdimësinë, cilësinë dhe sigurinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*

NJËSIA E PROKURIMIT